

VENDIM
Nr. 37, datë 21.1.2016

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT E REGJISTRUAR SI TË VETËPUNËSUAR, TË CILËT KRYEJNË VEPRIMTARI EKONOMIKE PROFESIONALE DHE PUNONJËSIT E PAPAGUAR TË FAMILJES QË PUNOJNË E BASHKËJETOJNË ME TË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi janë personat e regjistruar si person fizik, me ose pa të punësuar, si dhe me ose pa punonjës të papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike në një ose disa nga profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagat mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar në profesionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, përcaktohen në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në përcaktimin e këtyre pagave mbahen parasysh lloji i veprimtarisë profesionale, zona ku ajo zhvillohet, vitet e punës në profesion, numri i të punësuarve, paga për të njëjtin profesion në sektorin publik, vitet e punës në bazë të licencës në profesion dhe statusi i profesionit.

3. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, kategorizimi i bashkive dhe zonave ku zhvillohet veprimtaria është sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Paga mujore sipas llojit të profesionit, objekt i këtij vendimi, përbën kufirin minimal të pagës për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këto paga vetëdeklarohen nga tatimpaguesi përkatës dhe, kur administrata tatimore vëren se pagat e deklaruar për efekt të llogaritjes së kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë më të vogla nga paga respektive e përcaktuar në këtë vendim, ajo ka autoritetin t’i rivlerësojë, sipas nivelit të pagës përkatëse të përcaktuar në këtë vendim.

5. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët punojnë në profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, llogaritet në bazë të pagës minimale sipas vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

6. Kur ndonjë nga veprimtaritë profesionale, të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, kryhet nga persona që kanë edhe të punësuar ose edhe anëtarë të papaguar, paga mujore për të vetëpunësuarin sipas pikës 1, të këtij vendimi, e përcaktuar në aneksin nr. 2, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shtohet me 3 për qind për çdo të punësuar ose anëtar familje me kohë të plotë dhe 2 për qind për çdo të punësuar me kohë të pjesshme, por jo më shumë se paga maksimale.

7. Kur ndonjë nga veprimtaritë profesionale të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi kryhen nga persona që fillojnë veprimtarinë ekonomike profesionale për herë të parë, paga mujore e përcaktuar në tabelë, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në tri vitet e para kalendarike të ushtrimit të profesionit me leje/licencë, zbritet me 30 për qind të pagës sipas aneksit nr. 2, ndërsa për tri vitet e tjera kalendarike të ushtrimit të veprimtarisë me leje/licencë zbritet me 15 për qind të pagës sipas aneksit nr. 2, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

8. Kur veprimtaritë profesionale të përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi kryhen nga persona që janë edhe të punësuar ose kryejnë edhe aktivitete të tjera vetëpunësimi, paga mujore e përcaktuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi, por me kusht që shumat e pagave nga të gjitha veprimtaritë të mos kalojnë nivelin e pagës maksimale, vetëm për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore.

9. Mbështetur në pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pensionistët e regjistruar si persona fizikë të vetëpunësuar të vetëm, që punojnë në profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, nuk kanë detyrim për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në raste të tjera, paguajnë kontribut në nivelin minimal sipas përcaktimeve të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

10. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1. Lista e profesioneve

Nr.	Profesioni
1	Farmacist
2	Programues IT (programues te aplikacioneve/zhvillues <i>software</i>) aktivite te programimit informatik
3	Vlerësues i pasurisë
4	Avokat
5	Noter
6	Përmbaues
7	Konsulent/këshillues në fushën ekonomike, fiskut, sigurimeve, si: kontabilist, ekonomist, jurist, inxhinier, këshillues fiskal dhe profesione të fushave të tjera
8	Ekspert kontabël i regjistruar
9	Kontabilist i miratuar
10	Arkitektit
11	Inxhinier
12	Projektues
13	Agronom
14	Përkthyes
15	Shoqërues dhe shpjegues në udhëtime
16	Veteriner
17	Mësues (mësimdhënës)
18	Trajnues në veprimtari të ndryshme përfshirë edhe fushën e kulturës, artit dhe sportit
19	Mjek i përgjithshëm
20	Mjek i specializuar
21	Dentist i specializuar dhe dentist
22	Fizioterapist
23	Ndërmjetës në një proces gjyqësor

Aneksi 2. Aktivitete, profesionet dhe pagat referuese

Seksioni	Ndarja	Grupi	Klasa	Emërtimi i vep. Ekonom.	Profesioni	Kategoria e qendrave të bashkive, ku zhvillohet biznesi					Zona rurale e bashkisë përkatëse
						I	II	III	IV	V	
G	47	47.7	47.73	Shitja e artikujve farmaceutikë	Farmacist	57,500	57,500	53,475	50,600	47,725	40,250
J	62	62.0	62.01	Aktivite të programimit informatik	Programues IT (programues te aplikacioneve/zhvillues <i>software</i>) aktivite te programimit informatik	88,800	70,100	65,193	61,688	58,183	
L	68	68.3	68.32	Shërbime të vlerësimit të pasurive të paluajtshme	Vlerësues i pasurisë	73,800	62,600	58,218	55,088		
M	69	69.1	69.10	Aktivite juridike (ligjore)	Avokat	73,800	73,800	68,634	64,944	61,254	
M	69	69.1	69.10	Aktivite juridike (ligjore)	Noter	73,800	73,800	68,634	64,944	61,254	
M	69	69.1	69.10	Aktivite juridike (ligjore)	Përmbaues	62,600	52,300	48,639	46,024		
M	69	69.1	69.10	Aktivite juridike (ligjore)	Ndërmjetës në një proces gjyqësor	62,600	52,300	48,639	46,024		
M	69	69.2-70.2	69.2-70.22	Aktivite të llogarive dhe konsulencës	Konsulent/këshillues në fushën ekonomike, fiskut, sigurimeve, si kontabilist, ekonomist, jurist, inxhinier, këshillues fiskal dhe profesione të fushave të tjera.	73,800	62,600	58,218	55,088		

M	69	69.2	69.20	Aktivite të llogarive dhe konsulencës	Ekspert kontabël i regjistruar	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	69	69.2	69.20	Aktivite të llogarive dhe konsulencës	Kontabilist i miratuar	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	Arkitektit	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	Inxhinier	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	71			Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	Projektues	73,800	62,600	58,218	55,088	51,958	
M	74	74.9	74.90	Të tjera aktivite prof. shkenc. teknik	Agronom	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820
M	74	74.3	74.30	Aktivite përkthimi dhe interpretimi	Përkthyes	62,600	62,600	58,218	55,088		
M	74	74.3	74.30	Aktivite përkthimi dhe interpretimi	Shoqëruar dhe shpjegues në udhëtime	52,300	52,300	48,639	46,024		
M	75	75.0	75.00	Aktivite veterinare	Veteriner	62,600	62,600	58,218	55,088	51,958	43,820
P	85			Arsimi	Mësues (mësimdhënës)	58,100	55,100	51,243	48,488	45,733	41,325
P	85			Arsimi	Trajnues në veprimtari të ndryshme përfshirë edhe fushën e kulturës, artit dhe sportit.	62,600	52,300	48,639	46,024	43,409	
Q	86	86.2	86.21	Aktivite të mjekëve të përgjithshëm	Mjek i përgjithshëm	65,000	55,000	51,150	48,400	45,650	41,250
Q	86	86.2	86.22	Aktivite të mjekëve të specializuar	Mjek i specializuar	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	
Q	86	86.2	86.23	Aktivite të dentistëve	Dentist i specializuar dhe dentist	73,000	60,000	55,800	52,800	49,800	45,000
Q	86	86.9	86.90	Shërbime të tjera shëndetësore e kurative”: fizioterapi, qendra estetike ku afrohet shërbim mjekësor, qendra të trajtimit të vartësisë nga droga, qendra balneare, të kujdesit paliativ dhe të tjera	Fizioterapist	66,100	56,100	52,173	49,368		

Shënim. Kur kryhen aktivitetet profesionale në qendrat e bashkive të ndara në kategorinë V ose në zonën rurale të bashkive përkatëse dhe në tabelë nuk ka pagë të përcaktuar, si pagë referuese merret paga e përcaktuar në kategorinë IV, për profesionin përkatës.

Aneksi 3. Kategoria e qendrave të bashkive ku zhvillohet biznesi

			Kategoria e qendrave të bashkive, ku zhvillohet biznesi					Zona rurale e bashkisë përkatëse
Bashkia	Qarku	Qendra e bashkisë	I	II	III	IV	V	
38. Pustec	Korçë	Pustec					x	x
29. Libohovë	Gjirokastrë	Libohovë					x	x
45. Fushë-Arrëz	Shkodër	Fushë-Arrëz					x	x
28. Këlcyrë	Gjirokastrë	Këlcyrë					x	x
58. Konispol	Vlorë	Konispol					x	x
32. Tepelenë	Gjirokastrë	Tepelenë				x		x

3. Poliçan	Berat	Poliçan					x	x
8. Klos	Dibër	Klos					x	x
39. Has	Kukës	Krume					x	x
55. Delvinë	Vlorë	Delvinë					x	x
4. Skrapar	Berat	Çorovodë				x		x
30. Memaliaj	Gjirokastër	Memaliaj					x	x
31. Përmet	Gjirokastër	Përmet				x		x
34. Kolonjë	Korçë	Ersekë				x		x
26. Dropull	Gjirokastër	Jergucat						x
41. Tropojë	Kukës	B. Curri				x		x
57. Himarë	Vlorë	Himarë				x		x
25. Roskovec	Fier	Roskovec						x
13. Belsh	Elbasan	Belsh					x	x
19. Përrenjas	Elbasan	Përrenjas					x	x
54. Vorë	Tiranë	Vorë				x		x
60. Selenicë	Vlorë	Selenice					x	x
18. Peqin	Elbasan	Peqin					x	x
44. Mirditë	Lezhë	Rrëshen				x		x
5. Ura Vajgurore	Berat	Ura Vajgurore					x	x
6. Bulqizë	Dibër	Bulqizë				x		x
9. Mat	Dibër	Burrel				x		x
16. Gramsh	Elbasan	Gramsh				x		x
56. Finiq	Vlorë	Finiq					x	x
52. Rrogozhinë	Tiranë	Rrogozhinë					x	x
17. Librazhd	Elbasan	Librazhd				x		x
12. Shijak	Durrës	Shijak				x		x
23. Mallakastër	Fier	Ballsh				x		x
24. Patos	Fier	Patos				x		x
33. Devoll	Korçë	Bilisht				x		x
14. Cërrik	Elbasan	Cërrik					x	x
49. Vau i Dejës	Shkodër	Vau i Dejës					x	x
20. Divjakë	Fier	Divjakë					x	x
27. Gjirokastër	Gjirokastër	Gjirokastër			x			x
46. Malësi e Madhe	Shkodër	Koplik					x	x
47. Pukë	Shkodër	Pukë				x		x
1. Berat	Berat	Berat			x			x
2. Kuçovë	Berat	Kuçovë				x		x
40. Kukës	Kukës	Kukës			x			x
59. Sarandë	Vlorë	Sarandë			x			x
36. Maliq	Korçë	Maliq					x	x
42. Kurbin	Lezhë	Laç				x		x
7. Dibër	Dibër	Peshkopi			x			x
11. Krujë	Durrës	Krujë				x		x
51. Kavajë	Tiranë	Kavajë			x			x
43. Lezhë	Lezhë	Lezhë			x			x
37. Pogradec	Korçë	Pogradec			x			x
50. Kamzë	Tiranë	Kamzë				x		x
22. Lushnjë	Fier	Lushnjë			x			x
35. Korçë	Korçë	Korçë		x				x
61. Vlorë	Vlorë	Vlorë		x				x

21. Fier	Fier	Fier		x				x
48. Shkodër	Shkodër	Shkodër		x				x
15. Elbasan	Elbasan	Elbasan		x				x
10. Durrës	Durrës	Durrës		x				x
53. Tiranë	Tiranë	Tiranë	x					x

Shënim. Kur vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike profesionale, nga profesionet e mësipërme, kryhen në fshatra në juridiksionet sipas bashkëve, paga referuese zbritet me 20 % por jo më pak se paga minimale në shkallë vendi.

